

محمد بن عبد الله

KY ËSHTE I DËRGUARI I ALLAHUT

Tiranë, 2025

Titulli: KY ËSHTEË I DËRGUARI I ALLAHUT

Autori: Shoqata kulturore “Dija islame”

Përktheu nga arabishtja: Haxhi Shejkh Vullnet MERJA

Redaktoi: Jerida KULLA

Korrekttoi: Ma. Isra MERJA

Përgatiti për shtyp & Kopertina: Sabrie FEZA

Botoi: “Fondacioni i Kur’anit” - Tiranë, 2025

بسم الله الرحمن الرحيم

**Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit,
Mëshirëplotit!**

Hyrje

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve! Paqja e bekimi qoftë mbi më të nderuarin e krijesave të Allahut, Muhamedin e zgjedhur dhe mbi familjen e tij të pastër!

Me rastin e ditëlindjes së të Dërguarit të Allahut dhe javës së unitetit, të shpallur nga Imam Sejid Ali Khamenei (*Allahu e ruajttë!*), ne i paraqesim lexuesit të dashur këtë broshurë, që përcjell disa nga cilësitë e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), të cilat kanë një dimension shoqëror, në mënyrë që dashamirët ta njohin atë, të ecin në rrugën e tij dhe çdo mysliman që ka besuar në të, madje çdo njeri që udhëhiqet

nga një natyrë e pastër dhe një ndërgjegje e shëndoshë, të përfitojë nga morali i tij.

Gjithashtu, sjellim fjalët e disa mendimtarëve perëndimorë e lindorë, të cilët e kanë parë me drejtësi këtë personalitet të madh, të Dërguarin e mëshirës, Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve!

Shoqata kulturore “Dija islame”

PROFETI I PASHKOLLUAR, MËSOI DHE EDUKOI POPUJ

Allahu i Madhëruar thotë në Kur'anin e shenjtë:
“Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për gjynahet që bëni ju, jua dëshiron të mirën me gjithë zemër që ju të shkoni rrugës së drejtë dhe është i butë e i mëshirshëm me besimtarët”.¹

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) përfaqëson modelin e përsosur të humanizmit. Në personalitetin e tij ndodheshin të gjitha virtytet dhe vlerat e larta njerëzore. Ai ishte i ditur, bujar, inteligjent, i përkryer, model i urtësisë, i respektit e i madhështisë, i guximshëm, i devotshëm dhe mëshirë për mbarë krijesat. Ai ishte i pamëkatë dhe ishte në pedestalin më të lartë të moralit. Kur'ani i shenjtë thotë: **“...ti je me virtyte madhore”**.² Në veprat e tij nuk dukej asnjë mangësi e as në sjelljet e tij kundërshti.

Ai ishte zemërgjerë ndaj vështirësive dhe problemeve. Sakrifikoi ashtu si duhet në rrugën e Allahut të

1 Sure “Et Teube”, ajeti 128.

2 Sure “Kalem”, ajeti 4.

Madhëruar. Ishte i palëkundshëm në luftën përballë fuqive injorante, idhujtare e pagane për të përhapur drejtësinë, lirinë, mëshirën dhe dashurinë.

Për këtë, Allahu e bëri shembullin më të mirë për mbarë njerëzit, siç thuhet në Kur'anin e shenjtë: **“Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun”.**³

Sipas këtij ajeti të bekuar, është detyrë e të gjithë njerëzve që ta ndjekin dhe t'i zbatojnë porositë e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Vërtet, ne, umeti islam, jemi bashkësi e lartë, sepse të gjitha çështjet e jetës sonë i marrim nga libri madhështor, Fjala e fundit e Allahut në tokë, Kur'ani i shenjtë dhe nga njeriu i përkryer, i cili është në piedestalin më të lartë të moralit, vula e profetëve, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), të cilin Allahu e dërgoi mëshirë për mbarë botët dhe ai është vula e profecisë. Allahu, në Kur'an, thotë: **“Dhe Ne nuk të kemi dërguar ty (o Muhamed), veçse si mëshirë për botët”.**⁴

³ Sure “El Ahzab”, ajeti 21.

⁴ Sure “El Enbija”, ajeti 107.

Kjo mëshirë për mbarë botët, u zgjodh nga Allahu i Madhëruar në mesin shoqërisë së pashkolluar, të cilët edhe ata e njihnin si njeri të drejtë e besnik.

Edhe Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte i pashkolluar. Por i pashkolluar do të thotë se është i pastër me natyrën që ka krijuar Allahu dhe nuk ka mësuar në shkollë e as nga njerëzit e tjerë. As nuk është i ndikuar nga qytetërimet e kombeve të tjera, siç mund të thonë disa se ajo që ka sjellë, është prej qytetërimit ku ai jetonte. Ndërkohë që shoqëria ku lindi Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte shoqëria më e errët, më e humbur. Ajo është quajtur shoqëria e injorancës. Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk ka mësuar as nga lindorët, as nga perëndimorët. Për këtë, Allahu, në Kur'anin e shenjtë, në suren "El Ankebut", në ajetet 48-49 thotë: **"Para këtij, ti (Muhamed) nuk kishe lexuar kurrfarë libri e as që kishe shkruar gjë me dorën tënde; përndryshe, ndjekësit e së pavërtetës do të dyshonin. Përkundrazi! Ai (Kur'ani) është shpallje e qartë në zemrat e atyre, të cilëve u është dhënë dija. Shpalljet Tona i mohojnë vetëm keqbërësit"**. Pra, ti o Muhamed nuk dije as shkrim e as këndim para zbritjes së Kur'anit, sepse ishe i pashkolluar. Por kjo nuk do të thotë se Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte i paditur.

Nëse do të dinte shkrim e këndim, jobesimtarët do të dyshonin rreth Kur'anit e do të thoshin se këtë e ka përzgjedhur nga librat e mëparshëm dhe thotë se është nga Allahu. Mirëpo, të qenit e tij i pashkolluar është mrekulli. Ai solli Librin sfidues, i cili përmban lajmet e të shkuarve dhe të ardhmëve.

Vërtet, Kur'ani është mrekulli e përjetshme për Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Ai është argumenti më i madh dhe më i fuqishëm që vërteton profetësinë e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Përveç Kur'anit të shenjtë, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka pasur edhe mrekulli të tjera, të cilat i kanë parë dhe i kanë dëshmuar bashkëkohësit e tij. Të gjitha këto mrekulli, tregojnë qartë pozitën e lartë të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Është detyrë e të gjithë njerëzve që ta duan, ta respektojnë dhe ta pasojnë Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), të cilin Allahu e ka dërguar mëshirë për mbarë botët.

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte, është dhe do të mbetet mësuesi më i mirë për të gjithë njerëzit. Me anë të fjalës së Allahut, Kur'anit të shenjtë, ai arriti ta ndryshojë rrënjësisht

shoqërinë e asaj kohe. Ai u bë i dashur për njerëzit, sepse ftonte në drejtësi, në dashuri, në vëllazëri, në paqe, në siguri, në solidaritet dhe në dhembshuri.

Misionin e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e sqaron Kur'anin i shenjtë: **“Është Ai që u solli të analfabetëve një të Dërguar nga gjiri i tyre, për t’u lexuar atyre shpalljet e Tij, për t’i pastruar e për t’u mësuar Librin dhe Urtësinë, ndonëse ata më parë ishin vërtet në humbje të plotë”.**⁵

Dhe: **“Allahu u ka dhënë besimtarëve dhuratë të madhe, kur u solli një të dërguar nga gjiri i tyre, i cili ua lexon shpalljet e Tij, i pastron nga gjynahet dhe u mëson Librin (Kur'anin) e urtësinë (diturinë e thellë fetare), edhe pse më parë, me të vërtetë, ata ishin në rrugë krejt të gabuar”.**⁶

Në këto dy ajete, Allahu i Madhëruar sqaron se misioni i Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe i të gjithë profetëve, ka qenë udhëzimi i njerëzve në rrugën e drejtë. Mirëpo udhëzimi nuk mund të arrihet pa pastrim, edukim dhe mësim.

Interesante në këto dy ajete është se në fillim përmendet pastrimi e më pas mësimi. Kjo do të thotë se feja

⁵ Sure “Xhumua”, ajeti 2.

⁶ Sure “Al Imran”, ajeti 164.

e pastër islame i kushton vëmendje të madhe anës shpirtërore të njeriut. Ajo kërkon që njeriu të jetë si qelibari brenda tij. Feja islame, me anë të Kur'anit dhe Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), është e vetmja që siguron lumturinë e vërtetë të njeriut në të dy botët. Dija dhe morali janë dy krahët më të fortë që e bëjnë njeriun të udhëtojë drejt lumturisë.

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) porositi për dijen dhe kërkimin e saj. Në një hadith, ai ka thënë: “Kërkimi i diturisë është detyrë e çdo myslimani dhe myslimaneje”. Gjithashtu, ka thënë: “Kërkojeni diturinë prej djepit deri në varr”. Këto porosi Profeti ynë i dashur i jepte që shoqëria islame të edukohej dhe të ishte shembull për shoqëritë e tjera në edukim e moral. Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Unë jam dërguar që të përsos moralet e larta”.

Për sa kohë që qëndroi në Mekën e bekuar, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kurrë nuk hoqi dorë nga misioni i tij fisnik, edhe pse e lëndonin, e shanin, e ofendonin dhe e torturonin atë, së bashku me besimtarët që i besuan mesazhit të tij. Ai i duroi të gjitha keqbërjet, intrigat dhe padrejtësitë. Ai kurrë nuk u lodh dhe kurrë nuk u gjunjëzua. Përkundrazi, ishin jobesimtarët ata që u lodhën e u trishtuan, sepse fjalët e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishin të vërteta të padiskutueshme. Aq shumë

u lodhën e u stresuan jobesimtarët nga prania e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe nga mesazhi i tij paqësor, saqë vendosën ta ekzekutonin.

Por ishte urtësia e Allahut dhe fuqia e Tij që misioni të vazhdojë në Medinën e ndritur.

Pas mbërritjes në Medinë, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) filloi të bëjë organizimin për ndërtimin e një shoqërie të fortë islame, bazuar në pastërti dhe dije.

Ndërtimi i xhamisë

Xhamia ishte qendra e parë që ndërtoi Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), kur mbërriti në Medinë. Ajo xhami ishte qendra e adhurimit, e mësimi, e edukimit, e udhëheqjes dhe e drejtimit. Udhëheqësja e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk kishte vend të posaçëm, siç kanë sot udhëheqësit e shteteve nëpër botë, të cilët kanë pallatet e tyre presidenciale apo vilat, apo sarajet e ndryshme. Qendra e udhëheqjes së Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte xhamia. Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) punoi vetë në ndërtimin e xhamisë, krah për krah myslimanëve. Pas ndërtimit të xhamisë, u ndërtuan dhomat e tij, ngjitur me xhaminë.

Vëllazërimi

Për të ndërtuar një shoqëri të pastër dhe të fortë, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) bëri vëllazërimin mes emigruesve (muhaxhirëve) dhe përkrahësve vendas (ensarëve). Ky veprim qartëson më së miri se feja e pastër islame është fe e paqes, e dashurisë, e vëllazërisë dhe e solidaritetit. Allahu i Madhëruar, në Kur'anin e shenjtë, thotë: **“Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër, andaj pajtojini vëllezërit tuaj midis tyre dhe kijeni frikë Allahun, në mënyrë që ju të mëshiroheni”**.⁷

Me vëllazërimin mes besimtarëve, në Gadishullin Arabik u formua një shoqëri e re, larg dhunës e shtypjes. U formua një shoqëri, e cila sundohej nga harmonia, uniteti dhe respekti mes besimtarëve myslimanë. Ky vëllazërim shkatërroi ndasinë shtresore në fise e në ekonomi, duke vendosur si parim barazinë dhe drejtësinë shoqërore. Kështu që në Medinë u formua ajo shoqëri për të cilën Kur'ani i shenjtë thotë: **“Ju jeni populli më i mirë i dalë për**

⁷ Sure “El Huxhurat”, ajeti 10.

njerëzimin: (sepse) ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni Allahun”.⁸

Vëllazërimi u krye pas pesë apo tetë muajve të mbërritjes së Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Ai u tha myslimanëve: “Vëllazërohuni për hir të Allahut, dy e nga dy, vëllezër”. Pasi i vëllazëroi të gjithë myslimanët, mbeti Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*). Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i tha atij: “Unë të lashë ty për veten time. Ti je vëllai im dhe unë jam vëllai yt. Nëse dikush të përmend ty, i thuaj: ‘Unë jam rob i Allahut dhe vëllai i të dërguarit të Tij’. Ai që e thotë këtë pas teje, është gënjeshtar. Betohem në Atë që më dërgoi më të vërtetën, se unë të kam zgjedhur ty për veten time dhe ti je për mua në atë pozitë siç ishte Haruni për Musain, me përjashtim se nuk ka të dërguar pas meje. Ti je vëllai im dhe trashëgimtari im”. Pastaj mori dorën e tij (Aliut) dhe tha: “Ky është vëllai im!” Kështu, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) bëri vëllazërim mes tij dhe Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*).

Të gjitha thëniet dhe veprat e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) janë mësim dhe edukim për mbarë njerëzimin, sepse ai nuk fliste nga vetja e tij, por thëniet e tij ishin shpallje e shpallur. Këtë e dëshmon edhe Kur’ani i shenjtë, i cili thotë: “**Ai nuk flet**

⁸ Sure “Al Imran”, ajeti 110.

sipas qejfit të vet, por ajo (që thotë) është vetëm shpallje hyjnore, që i vjen atij. Atë ia ka mësuar atij një (engjell) shumë i fuqishëm (Xhebraili)”⁹.

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u mëson të gjithë njerëzve se te Allahu i Madhëruar nuk ka dallim mes të bardhit dhe të ziut, arabit dhe jo arabit. Ai thotë se dallimi i vetëm është devotshmëria. Këtë e dëshmon edhe Kur’ani i shenjtë: “...**Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që është më i devotshëm...**”¹⁰

Për njëzet e tre vjet me radhë Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) sakrifikoi në rrugën e edukimit dhe të mësimi. Gjithmonë këshillonte për vepra të mira. Falë mësimave dhe porosive të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) Islami u përhap dhe po përhapet në mbarë rruzullin tokësor. Dita-ditës Profeti ynë i dashur pushton zemrat e miliarda njerëzve, qofshin myslimanë apo jomyslimanë.

Të qenit e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) mësues dhe edukues për mbarë njerëzimin e dëshmon edhe Hytbeja e Lamtumirës, ku ai u drejtohet të gjithë njerëzve.

9 Sure “En Nexhm”, ajetet 3-5.

10 Sure “Huxhurat”, ajeti 13.

Ja disa prej paragrafëve të Hytbes së Lamtumirës të Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!):

“... O njerëz, frikësojuni Zotit dhe respektojeni Atë, bëhuni të njerëzishëm dhe të drejtë ndaj të tjerëve! ... Vërtet, gjaku, nderi dhe pasuria janë të shenjta për ju, deri sa të takoheni me Krijuesin tuaj, ashtu siç është e shenjtë kjo ditë në këtë muaj dhe në këtë vend. Ruajuni, respektoni dhe nderoni vlerën e personalitetit! Njeriu është vepër madhështore e Allahut. Mjerë ai që e përçmon nderin dhe dinjitetin e veprës së Tij!

O njerëz, ju sigurisht do të ktheheni tek Allahu i Madhëruar dhe Ai do t’ju thërrasë të përgjigjeni për veprat dhe punën tuaj.

O njerëz, dijeni se ka përfunduar koha e padijes dhe e traditave të këqija, të cilat i kanë sjellë aq fatkeqësi gjinisë njerëzore. Unë ju kam treguar rrugën e shpëtimit, drejt së cilës duhet ecur. Sendet që ju janë dhënë amanet, ruajini si të ishin tuajat dhe kthejuani ato besnikërisht dhe me kohë atij që i përkasin. Gjakmarrja është e ndaluar...

... Respektojeni farefisninë. Përmbushni besnikërisht detyrat dhe detyrimet ndaj burrit dhe gruas, si dhe ndaj prindërve dhe fëmijëve! Ruhuni nga imoraliteti, tradhtia bashkëshortore dhe xhelozia. Imoraliteti dhe tradhtia bashkëshortore janë gjynahe të rënda, ndërsa xhelozia sjell përçarje në martesë. Martohuni me ato që i doni, e kur Zoti, me vullnetin e Vet do t’ju bashkojë, atëherë

respektojeni dhe duaeni njëri-tjetrin dhe jetoni në dashuri e harmoni! O bashkëshortë, silluni ndaj grave tuaja me shumë mirësi dhe dashuri!

O njerëz, largohuni ngatërresave dhe përgojimit! Le të jenë të mallkuar në të dyja botët ata që u bëjnë shpifje grave të ndershme! ...Gratë tuaja janë dorëzuar në besë të Zotit; pra respektojeni këtë amanet të Zotit...

O njerëz, dijeni dhe mos harroni se të gjithë myslimanët janë vëllezër. Ju jeni plotësisht të barabartë në të drejta dhe në detyra. Arabi ndaj joarabit nuk ka kurrfarë përparësie e kjo vlen edhe për të ziun ndaj të bardhit, përveçse në devotshmëri. Të gjithë ju jeni pasardhësit e Ademit e Ademi është krijuar nga dheu.

O njerëz, kujdesuni për njëri-tjetrin, duaeni dhe ndihmojeni njëri-tjetrin! Mos guxoni ta fyeri apo ta grabitni njëri-tjetrin. Këto janë gjynahe të rënda. Merrni vetëm atë që ju jepet me dëshirë! Respektojeni pacenueshmërinë e pasurive tuaja, deri sa të jeni në frymën e Ligjeve të Zotit... Kurrë mos e shkelni të drejtën dhe nderin e tjetrit! Mos i bëni dhunë vetes! Mos harroni se mëshira është një ndër themelet e Islamit!

O njerëz, dëgjoni se ç'po ju them dhe mbajeni mend mirë! Po ju lë Librin e Zotit, Kur'anin, të cilit, nëse i përmbaheni, gjithnjë do t'ju ruajë që të mos e humbni rrugën e drejtësisë dhe të së vërtetës. Kur'ani është libër i qartë dhe i shenjtë, vepër e vërtetë e Allahut dhe fjala e Tij, në vërtetësinë e të cilit nuk ka asnjë dyshim. Para vetes e keni tërë jetën time, të gjitha fjalët dhe veprat

e mia, gjithçka që kam folur dhe punuar. Jam përpjekur të jenë në përputhje të plotë me urdhrat e Allahut, vërtet nuk do të gaboni, nëse i përmbaheni Kur'anit (Librit të Zotit) dhe familjes sime.

O njerëz, pas meje nuk do të vijë më i Dërguar tjetër nga Zoti dhe pas jush populli nuk do të ketë më Pejgamber! Pra, bëni ibadet dhe adhuronit Zotin; agjëroni muajin e Ramazanit; jepni zekatin me zemër të plotë dhe të kënaqur dhe kryejeni haxhin. Kështu, do të hyni në Xhenetin e Zotit të Madhëruar!

O njerëz, thoni gjithnjë të vërtetën e pastër! Asnjëherë të mos ju largojë urrejtja nga rruga e drejtë. Drejtësia është motra e devotshmërisë. Frikësojuni Allahut se Ai i sheh mirë veprimet tuaja!

O njerëz, e dëgjuat porosinë time. Atëherë, futeni atë në zemrën tuaj dhe në jetën tuaj! Të gjithë ata që i dëgjuan fjalët e mia, le t'ua përcjellin atyre që nuk i kanë dëgjuar, se ndodh që ata i kuptojnë më mirë.

O Zoti im, a e përmbusha detyrën dhe misionin e besuar?"

Mbi njëqind mijë haxhinj folën njëzëri: "O i Dërguari i Zotit, ti e përmbushë misionin tënd besnikërisht dhe na e komunikove atë që të urdhëroi Zoti..."

Atëherë, Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) tha: "O Zot, dëshmo! O Zot, dëshmo! O Zot, dëshmo!" Atë ditë, nga Zoti i Lartësuar, iu shpall ajeti:

“Sot kam përsosur fenë tuaj, plotësova dhuntinë time për ju dhe jam i kënaqur që Islami të jetë feja juaj”.¹¹

Sa të mrekullueshme këto porosi! Vërtet, ato janë shkolla më e mirë e edukimit dhe e mësimit për mbarë njerëzit, pa dallim kombi, gjuhe, race e feje. Duke lexuar porositë e kësaj hytbeje madhështore, themi me plot bindje se Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është mësuesi dhe edukuesi i mbarë popujve, edhe pse shumica e tyre nuk e shfaqin. Fjalët e kësaj hytbeje të begatë janë receta më e përkryer për mbarëvajtjen e jetës së njeriut në të gjitha aspektet e jetës së tij.

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka qenë vetë Kur’ani, sepse i gjithë Kur’ani ishte kristalizuar në qenien e tij. Kur ecte, kur fliste, e ndriçonte çdo gjë me dritën e Kur’anit.

Bernard Shou, në librin e tij për Muhamedin, thotë: “Gjithmonë e kam vlerësuar shumë besimin e Muhamedit, thjesht për forcën e tij të jashtëzakonshme. Mendimi im është se Islami është besimi i vetëm, i aftë, për të drejtuar në mënyrë të suksesshme ndryshimet e shumta në jetë. Jam i bindur se, nëse një person i njëjtë do të ishte përballur me problemet e sotme, ai do t’i kishte zgjidhur ato me sukses,

¹¹ Sure “El-Maide”, ajeti 3.

duke i sjellë njerëzimit paqe dhe lumturinë e nevojshme. Parashikoj që besimi i Muhamedit do të pranohet në Evropën e të nesërmes, siç ka filluar të pranohet në Evropën e sotme”.¹²

Me rastin e ditës së kalimit nga kjo jetë e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), Fondacioni i Kur’anit ka përkthyer libërthin me titull: “Ky është i Dërguari i Allahut”.

Libri është përgatitur nga shoqata kulturore “Dija islame”, me qendër në Bejrut, Liban.

Fondacioni i Kur’anit falënderon të gjithë ata që ndihmuan në përgatitjen e këtij libërthi. Allahu i Madhëruar i shpërbleftë me të mirat e Tij të pafundme në të dyja botët!

O Zoti ynë! Na mundëso të jemi në gjurmët e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në këtë jetë dhe na dhuro shëfatin e tij në Jetën Tjetër!

Haxhi Shejkh Vullnet MERJA

¹² “The Genuine Islam”, Singapore, vol. 1, Nr. 8, 1936.

Drita e të Dërguarit të Allahut

Drita e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u shfaq në të gjitha fushat dhe mjediset, qofshin ato individuale apo shoqërore, në shoqërimin e tij me njerëzit apo në udhëheqjen e tij të shoqërisë, si dhe në drejtimin e tij të ecurisë së njerëzimit në përgjithësi.

Në çdo çështje, qoftë e madhe apo e vogël, e gjejmë Profetin të ndritshëm, si një dritë e fuqishme dhe një shembull i përhershëm për njerëzimin. Si të mos jetë kështu?! Ai është njeriu më i përsosur, të cilin Allahu i Lartësuar e ka përshkruar me fjalët: **“Vërtet, ti je mbi një moral të madh”**¹³ dhe e ka paraqitur si shembull për njerëzimin: **“Ju keni tek i Dërguari i Allahut një shembull të shkëlqyer, për atë që shpreson tek Allahu dhe dita e fundit, dhe e përmend Allahun shumë”**.¹⁴

Ne do të paraqesim më poshtë një aspekt nga drita e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), që lidhet me moralin e tij shoqëror dhe shoqërimin e tij me njerëzit.

13 Sure “El Kalem”, ajeti 4.

14 Sure “El Ahzab”, ajeti 21.

Takimet e tij

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Asnjëherë i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk i ka shtrënguar dorën dikujt dhe pastaj ta tërhiqte dorën e tij i pari, deri sa tjetri ta tërhiqte dorën. Kurrë nuk ka ndodhur që dikush t’i drejtohej për një nevojë apo t’i fliste dhe i Dërguari të largohej para se të largohej vetë ai person”.¹⁵

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Nëse ndodhte që një burrë t’i shtrëngonte dorën, i Dërguari i Allahut nuk e lëshonte dorën, deri sa tjetri të ishte personi që e lëshonte. Kur njerëzit e kuptuan këtë, ata, kur i shtrëngonin dorën, e anonin dorën e tyre për ta tërhequr nga dora e tij”.¹⁶

¹⁵ “Mekarimul Akhlak”, f. 22.

¹⁶ “El Kafi”, vëll. 2, f. 671.

Ulja e tij

Kur Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) ka pyetur babanë e tij, Prijësin e besimtarëve, Imam Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*), për mënyrën e uljes së të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ai është përgjigjur: “Ai nuk ulej dhe as nuk ngrihej, veçse me përmendjen e Allahut. Kur mbërrinte tek një grup njerëzish, ulej aty ku ishte vendi i lirë dhe urdhëronte edhe të tjerët të vepronin kështu. Çdo shoqëruesi të tij i jepte pjesën e tij (nga vëmendja dhe mirësia). Askush prej atyre që ishin me të, nuk mendonte se dikush tjetër ishte më i nderuar tek ai se sa vetë ai. Me këdo që rrinte, ai duronte, deri sa tjetri të ngrihej. Kush i kërkonte diçka, nuk kthehej pa të ose pa një fjalë të mirë. Zemërgjerësia e tij i përfshinte të gjithë, saqë për ta ishte si baba dhe të gjithë ishin të barabartë tek ai. Ulja e tij ishte ulje modestie dhe turpi. Në praninë e tij nuk ngrihej zëri, nuk shante askush, as nuk cenoheshin nderet. Gabimet që ndodhnin aty, nuk përhapeshin jashtë dhe pjesëmarrësit ishin të barabartë, të lidhur nga devotshmëria, të përulur, duke respektuar të moshuarin, duke mëshiruar të voglin, duke ndihmuar të nevojshmin dhe duke mbrojtur të huajin”.

Imam Hyseni vazhdon e pyet babanë e tij: “Si ishte sjellja e tij me ata që rrinin në shoqërinë e tij?”

Imam Aliu i përgjigjet: *“Ishte gjithmonë i buzëqeshur, i butë në sjellje, i butë në qasje. E kalonte pa e vënë re atë që nuk e pëlqente. Nuk e humbte shpresën tek ai askush, as nuk zhgënjente atë që shpresonte prej tij... Kur fliste, shoqëruesit e tij rrinin të heshtur, sikur zogjtë të ishin ulur mbi kokat e tyre. Kur heshtte ai, ata flisnin. Nuk grindeshin për fjalën pranë tij. Kur fliste dikush, ai e dëgjonte deri në fund, dhe për të, fjala e fundit ishte po aq e rëndësishme sa e para. Qeshte me atë që qeshnin ata dhe habitej me atë që habiteshin ata. Duronte me të huajin për ashpërsinë në pyetjen apo fjalët e tij, aq sa shokët e tij sillnin të huaj që ai t’i ndihmonte. Dhe thoshte: ‘Kur ta shihni dikë që ka një nevojë, ndihmojeni’. Nuk pranonte lavdërim veç nga ai që ia kthente me të njëjtën masë dhe nuk i ndërpriste fjalën askujt, derisa të përfundonte, përveçse nëse e ndalonte me këshillë apo ngrihej”.*

Imam Hyseni e pyet për heshtjen e të Dërguarit të Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!). Imam Aliu i përgjigjet: *“Heshtja e tij ishte për katër arsye: durim, kujdes, maturi dhe mendim. Për sa i përket maturisë, ajo ishte në barazinë e shikimit dhe të dëgjimit mes njerëzve. Mendimi i tij ishte për atë që mbetet dhe për atë që zhduket. Ai kishte bashkuar durimin dhe këmbënguljen; asgjë nuk e zemëronte dhe asgjë nuk e nxirrte nga vetja. Kujdesin e kishte në katër gjëra: të merrte gjërat e bukura, që të tjerët të merrnin shembull, të linte gjërat e shëmtuara, që të tjerët të largoheshin prej tyre; të*

mendonte gjithmonë për përmirësimin e umetit të tij dhe të vepronte për ato që i sillnin të mira kësaj bote dhe Botës Tjetër.”¹⁷

*Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Asnjëherë nuk është parë që ai të vendoste këmbën e tij përpara këmbës së dikujt që ishte ulur pranë tij. Kur vendosej para dy çështjeve, ai zgjidhte më të vështirën prej tyre. Nuk e merrte kurrë hakun për veten nga një padrejtësi, përveçse kur cenoheshin të shenjtit e Allahut, atëherë zemërimi i tij ishte vetëm për Allahun e Madhëruar e të Lartësuar... Shikimi i tij ishte me hedhje të lehta të syve... Kur ecte, ishte sikur zbriste nga një vend i lartë në një të pjerrët... Shoqëruesit e tij nuk grindeshin për fjalën pranë tij. Dhe ai që e dëgjonte të fliste, thoshte: ‘Nuk kam parë me sytë e mi askënd si ai, as para tij, as pas tij’”.*¹⁸

*Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Kur i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) hynte në një shtëpi, ulej në vendin më të afërt që i dilte përpara”.*¹⁹

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “I Dërguari i Allahut e ndante vështrimin e tij midis shokëve, duke i parë të

¹⁷ “El Mekarim”, f. 15; “El Biharul”, vëll. 16, f. 153. E ka transmetuar, gjithashtu, edhe Es Saduku në “Ujunul Akhbar”, vëll. 2, f. 285.

¹⁸ “Mekarimul Akhlak”, f. 22.

¹⁹ “El Kafi”, vëll. 2, f. 662.

gjithë në mënyrë të barabartë. Ai nuk i ka shtrirë kurrë këmbët para shokëve të tij”.²⁰

²⁰ “El Kafi”, vëll. 2, f. 671

E folura e tij

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) e ka përshkruar të Dërguarin e Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) duke thënë: “Ai nuk ishte i vrazhdë, as i ashpër, as teprues në qeshje, as fjalështhurur, as përgojues dhe as lavdërues i tepruar...”²¹

Në një fjalim tjetër, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë për Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*): “Kurrë nuk kundërshtonte askënd në bisedë, që ai të heshtte, deri sa tjetri të heshtte. Kishte larguar veten e tij nga tri gjëra: polemika e kotë, të folurit e tepërt dhe ajo që nuk i përkiste. Ndërsa prej njerëzve kishte lënë tri gjëra: nuk e përqeshte askënd, nuk e turpëronte, nuk i kërkonte gabimet apo të metat e tij. Nuk fliste veçse në atë që shpresonte shpërblimin e Allahut. Nuk i thoshte askujt ndonjë gjë që e urrente. Thoshte: ‘Më të mirët nga ju janë ata që kanë moralin më të mirë’. Ai nuk e përçmonte shijen e ushqimit, por as nuk e lavdëronte”.²²

21 “El Mekarim”, f. 15; “El Biharu”, vëll. 16, f. 153; E ka transmetuar Es Saduku në “Ujunul Akhbar”, vëll. 2, f. 285.

22 “Mekarimul Akhlak”, f. 22.

Me njerëzit

I Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij) ka thënë: *“Ne, profetët, jemi urdhëruar të sillemi me butësi e mirëkuptim me njerëzit, ashtu siç jemi urdhëruar të zbatojmë detyrimet (fetare)”*.²³

Kur mungonte ndonjë prej vëllezërve të tij (besimtarë) për tri ditë, i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) pyeste për të. Nëse nuk ishte i pranishëm, lutej për të; nëse ishte i pranishëm, e vizitonte; nëse ishte i sëmurë, i shkonte për vizitë”.²⁴

I Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: *“Nuk ndodhte që ta linte dikë të ecte me të, nëse ai (Profeti) ishte mbi kafshë (i hipur), por e merrte me vete. Nëse ai refuzonte, i thoshte: ‘Ec përpara meje dhe do të më gjesh në vendin që do të shkosh’”*.

Hysen ibn Zejdi tregon: *“E pyeta Imam Xhaferr Sadikun (Paqja qoftë mbi të!), nëse i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) bënte biseda të gëzueshme”*.

²³ “Amali” i Tusit, f. 493.

²⁴ “Mekarim”, f. 19.

Ai tha: “Allahu e përshkroi me moral të madh, edhe në shaka. Allahu i dërgoi profetët e Tij dhe disa prej tyre kishin ashpërsi (në sjellje)²⁵. Ndërsa Muhamedin (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) e dërgoi me dhembshuri e mëshirë. Prej dhembshurisë së tij për umetin ishte se ai bënte shaka me ta, që askush të mos e ngrinte në një shkallë të lartë, sa të mos e shihte atë (Profetin). Më ka treguar babai im, Muhamedi, atë që babai i tij, Aliu e kishte dëgjuar nga babai i tij, Hyseni dhe ky, nga babai i tij, Aliu (Paqja qoftë mbi të!) se i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), kur e shihte ndonjë prej shokëve të tij të mërzitur, e gëzonte me shaka. Ai (Profeti) thoshte: ‘Allahu e urren atë që ngryset (që mban fytyrë të mërzitur) para vëllezërve të tij’”.²⁶

²⁵ “Mekarim”, f. 22, Hadithi 34.

²⁶ “Resailu Esh Shehjd Eth Thanij”, f. 326.

Me të varfrit

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Nuk ndodhte që dikush t’i kërkonte të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) diçka prej kësaj bote (gjë materiale) dhe ai të mos ia jepte. Një grua dërgoi djalin e saj te Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe i tha: ‘Shko tek ai (Profeti) dhe kërkoji diçka. Nëse thotë se nuk kemi gjë, thuaji: ‘Më jep këmishën tënde’. Djali shkoi dhe Profeti mori këmishën e tij dhe ia dha. Në një variant tjetër thuhet: “Ia hodhi këmishën”. Atëherë Allahu i shpalli:

﴿وَلَا تَجْعَلْ يَدَكَ مَغْلُولَةً إِلَىٰ عُنُقِكَ وَلَا تَبْسُطْهَا كُلَّ الْبَسْطِ فَتَقْعُدَ مَلُومًا مَّحْسُورًا﴾

“Mos e bëj dorën tënde të lidhur fort pas qafës sate, e as mos e shtrij krejt shtrirë, që të mbetesh i qortuar dhe i penduar”.²⁷

²⁷ Sure “Isra”, ajeti 29.

Përmbushja e nevojave

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Asnjëherë nuk ndodhte që t’i kërkohej diçka dhe ai (Profeti) të thoshte: ‘Jo’. Asnjëherë nuk e ktheu ndonjë kërkuar, pa ia plotësuar nevojën, ose së paku duke i thënë një fjalë të mirë”.²⁸

Kujdesi për pamjen e jashtme

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) shihej në pasqyrë dhe rregullonte flokët, i krihte ato. Ndonjëherë shikonte edhe në ujë dhe i rregullonte flokët. Ai zbukurohej për shokët e tij, por më shumë zbukurohej për familjen e tij. Shpeshherë thoshte: “Allahu e do robin e Tij që, kur del tek vëllezërit e tij, të përgatitet dhe të zbukurohet për ta”.²⁹

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e*

²⁸ “Mekarimul Akhlak”, f. 22.

²⁹ “Mekarimul Akhlak”, f. 34.

tij!) shpenzonte për aromë (parfum) më shumë se sa shpenzonte për ushqim”.³⁰

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), duke përshkruar të Dërguarin e Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ka thënë: “Ai njihej nga aroma e mirë (parfumi i tij), kur afrohej”.³¹

“Ai i priste thonjtë dhe i shkurtonte mustaqet ditën e xhuma, para se të dilte për namaz”.³²

Enes ibn Maliku ka thënë: “I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kishte një ngjyrë të ndritshme, sikur ngjyra e margaritarit. Kur ecte, ecte me përkulje të lehtë (me qetësi e madhështi). Nuk kam nuhatur ndonjë aromë miski apo ambri më të mirë se aroma e tij, e as nuk kam prekur ndonjë pëlhurë mëndafshi, të trashë apo të hollë, më të butë se dora e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*)”.³³

³⁰ “El Kafi”, vëll. 6, f. 512.

³¹ “Mekarimul Akhlak”, f. 22.

³² “El Mustedrek”, vëll. 1, f. 414.

³³ “Mekarimul Akhlak”, f. 24.

Përrulësia e tij

Imam Muhamed Bakiri (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Erdhi një engjëll tek i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe i tha: ‘O Muhamed! Zoti yt të përcjell selam dhe të thotë: ‘Nëse dëshiron, ta bëj sheshin e Mekës të mbushur me gurë të artë’. Atëherë Profeti ngriti kokën drejt qiellit dhe tha: ‘O Zot! Një ditë më jep ushqim, që të të falënderoj, e një ditë më lër të kem uri, që të të lutem Ty!’”³⁴

Imam Muhamed Bakiri (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Erdhi një engjëll tek i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe i tha: ‘Allahu të jep mundësinë të zgjedhësh: të jesh një rob i përrulur dhe i dërruar, ose të jesh një mbret i dërruar’. Profeti e pa Xhibrilin (Paqja qoftë mbi të!) dhe ai i bëri me shenjë që të përrulej. Atëherë tha: ‘Do të jem një rob i përrulur dhe i dërruar’. Engjëlli tha: ‘Edhe kështu, kjo nuk të pakëson aspak nga ajo që është tek Zoti yt’. Ndërkohë kishte me vete çelësat e thesareve të tokës”.³⁵

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “...Në të gjendet shembulli për ithtarit dhe ngushëllimi për atë që kërkon ngushëllim. Njeriu më i dashur për Zotin është kush i shkon pas

³⁴ “Ujunul Akhbaru” Er Rida, vëll. 1, f. 33, Hadithi 36.

³⁵ “El Kafi”, vëll. 2, f. 122.

Profetit të Tij e ecën në gjurmët e tij. Ai s'ia hodhi kurrë sytë kësaj bote me dashuri e mori prej saj fare pak. Nga tërë njerëzit e botës, ai ishte më pak i nginjuri e me barkun më të boshatisur. Gjithë bota iu dha, po ai s'pranoi që t'i jepej. Kur mësonte që Zoti s'e donte një gjë, e urrente edhe ai; po ta quante Zoti të ulët një gjë, e quante edhe ai; po ta gjykonte Zoti të vogël një gjë, do ta gjykonte edhe ai. Në dashurofshim atë që urrejnë Zoti e Profeti i Tij e në i dhënçim rëndësi asaj që Zoti dhe Profeti i Tij s'i japin rëndësi, kjo do të sillte një ndarje të dhimbshme nga Zoti e shkeljen e urdhrave të Tij. Profeti i shenjtë e kishte zakon të hante ulur në tokë dhe shtrohej njësoj si skllevoërit. Ai i ndreqte këpucët me duart e tij dhe i arnonte rrobat me duart e tij. Ai mund t'i hipte një gomari të pashaluar dhe mund të ulte edhe dikë tjetër prapa vetes. Një herë gjeti në derën e shtëpisë së tij një perde me piktura e i tha njërës prej grave të tij: 'O filane, ma hiq nga sytë këtë gjë, sepse, po ta shikoj, kujtohem për botën dhe joshjet e saj. Kështu e largonte ai zemrën e tij nga kjo botë dhe e dëbonte kujtimin e saj nga mendja. Donte që tundimet e saj të mbeteshin të fshehta për sytë e tij, që të mos kërkonte veshje të mira prej saj, të mos e shikonte si vend për të ndenjur dhe të mos ushqente shpresa për të jetuar në të. Prandaj dhe e fshiu nga mendja, e dëboi nga zemra dhe e mbajti të fshehtë nga sytë e tij. Ai që urren një gjë, duhet të urrejë shikimin e saj dhe dëgjimin rreth saj...'”³⁶

Dejlamiu në librin “El Irshad” thotë: “I Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e

³⁶ “Nehxhul Belaga” (Kulmet e fjalës), Hytbeja 160.

tij!) e qepte vetë rrobën e tij, e arnonte vetë këpucën e tij, e milte delen e tij, hante bashkë me shërbëtorin, rrinte ulur në tokë, hipte mbi gomar dhe merrte dikë tjetër pas vetes. Nuk e pengonte modestia që t'i bartte vetë gjërat që blinte nga tregu për në shtëpinë e tij. I jepte dorën të pasurit dhe të varfrit dhe nuk e tërhiqte dorën nga dora e tjetrit, deri sa ta tërhiqte ai vetë. Përhëndeste atë që i dilte përpara, qoftë i pasur apo i varfër, i madh apo i vogël. Nuk e përçmonte atë ku ishte ftuar, qoftë edhe për hurma të thara e të ashpra. Ishte i kursyer në shpenzime, fisnik në natyrë, i këndshëm në shoqëri, me fytyrë të çelur, buzëqeshës pa qeshur me zë, i pikëlluar pa qenë i vrenjtur, i përulur pa qenë i nënshtruar, bujar pa e tepruar, me zemër të butë dhe i mëshirshëm me çdo mysliman. Asnjëherë nuk lëshoi gromësima nga ngopja dhe asnjëherë nuk e shtriu dorën e tij nga lakmia”.³⁷

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “I Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) nuk hëngri asnjëherë i mbështetur, që kur e dërgoi Allahu i Madhëruar deri kur e mori Ai (pra deri në vdekje). Ai hante siç ha rob i dhe ulej siç ulet rob i”. Unë (transmetuesi) i thashë: “Përse?” Ai tha: “Nga përulësia ndaj Allahut të Madhëruar”.³⁸

Qëllimi i ‘mbështetjes’, sipas dukjes, është mbështetja mbi jastëk, në formën që ishte e njohur te mbretërit dhe sundimtarët e jo mbështetja mbi tokë me dorë.

³⁷ “El Irshad li Dejlami”, K. 32, f. 115.

³⁸ “El Kafi”, vëll. 6, f. 270.

Durimi i tij

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Allahu i Madhëruar e dërgoi Muhamedin (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe e urdhëroi me durim dhe butësi. Allahu i tha:

﴿وَاصْبِرْ عَلَىٰ مَا يَسْأَلُونَ وَاعْجِزْهُمْ هِجْرًا جَمِيلًا * وَذَرْنِي وَالْمُكَذِّبِينَ أُولِي النَّعْمَةِ﴾

“Duro për atë që thonë dhe largoju atyre me një largim të bukur. Dhe më lër Mua me gënjeshtarët, pasanikët”.³⁹

Përsëri i tha:

﴿ادْفَعْ بِالَّتِي هِيَ أَحْسَنُ فَإِذَا الَّذِي بَيْنَكَ وَبَيْنَهُ عَدَاوَةٌ كَأَنَّهُ وَلِيٌّ حَمِيمٌ * وَمَا يُلْقَاهَا إِلَّا الَّذِينَ صَبَرُوا وَمَا يُلْقَاهَا إِلَّا ذُو حَظٍّ عَظِيمٍ﴾

“Nuk barazohet e mira me të keqen! Të keqen ktheje me të mirë e atëherë armiku yt do të të bëhet menjëherë mik i ngushtë. Ky virtyt u dhurohet vetëm atyre që durojnë dhe vetëm atyre që kanë një fat të madh”.⁴⁰ Kështu ai duroi për ato gjëra të rënda, që i bënë

³⁹ Sure “El Muzzemmil”, ajetet 10-11.

⁴⁰ Sure “Fussilet”, ajetet 34-35.

dhe me të cilat e akuzuan, saqë iu rëndua kraharori. Atëherë Allahu i shpalli:

﴿وَلَقَدْ نَعْلَمُ أَنَّكَ يَضِيقُ صَدْرُكَ بِمَا يَقُولُونَ * فَسَبِّحْ بِحَمْدِ رَبِّكَ وَكُنْ مِنَ السَّاجِدِينَ﴾

“Ne e dimë mirë, që ty të ngushtohet zemra nga fjalët e tyre, prandaj, lartësoje Zotin tënd duke e lavdëruar dhe bëhu prej atyre që i përulen Atij duke u falur!”⁴¹

Pastaj ata e përgënjeshtroan dhe e sulmuan, gjë që e hidhëroi. Atëherë, Allahu i shpalli:

﴿قَدْ نَعْلَمُ إِنَّهُ لَيَحْزُنُكَ الَّذِي يَقُولُونَ فَإِنَّهُمْ لَا يَكْذِبُونَكَ وَلَكِنَّ الظَّالِمِينَ بِآيَاتِ اللَّهِ يَجْحَدُونَ * وَلَقَدْ كُذِّبَتْ رُسُلٌ مِنْ قَبْلِكَ فَصَبَرُوا عَلَى مَا كُذِّبُوا وَأَوْدُوا حَتَّى أَتَاهُمْ نَصْرُنَا﴾

“Ne e dimë se ty të zemëron ajo që thonë ata. Në të vërtetë, nuk je ti ai që po mohojnë ata, por keqbërësit po mohojnë shpalljet e Allahut. Edhe para teje (o Muhamed!), shumë të dërguar janë mohuar, por ata e kanë duruar mohimin dhe lëndimin (që kanë pësuar), derisa u ka ardhur ndihma Jonë...”⁴²

Atëherë, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e detyroi veten e tij me durim. Ata e tepronin, ai përmendte Allahun e Madhëruar dhe të Lartësuar; ata e përgënjeshtrojnë, Profeti thoshte:

41 Sure “El Hixhr”, ajetet 97-98.

42 Sure “El En’am”, ajetet 33-34.

“Unë kam duruar për veten time, për familjen time dhe për nderin tim, por nuk kam durim, kur përmendet Zoti im”. Atëherë Allahu (i Madhëruar dhe i Lartësuar) shpalli: **“Prandaj, duroje atë që thonë ata”**.⁴³ Kështu ai duroi në të gjitha gjendjet e tij. Pastaj u përgëzua me pasardhësit e tij, me imamët dhe ata u përshkruan me durim, siç thotë Allahu i Madhëruar: **“Ne zgjodhëm prej tyre prijës, të cilët udhëzonin me urdhrat Tanë, për sa kohë që ishin të durueshëm dhe besonin bindshëm”**.⁴⁴

Në atë moment, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) tha: “Durimi në besim është si koka në trup”. Allahu ia shpërbleu këtë dhe shpalli: **“Kështu u përmbush premtimi i bukur i Zotit tënd ndaj izraelitëve, për shkak të durimit që treguan. Ndërsa ndërtesat dhe kullat e Faraonit dhe të popullit të tij Ne i shkatërruam”**.⁴⁵

Atëherë ata thanë: “Ky është përgëzim dhe hakmarrje. Prandaj Allahu ia lejoi atij luftimin e idhujtarëve dhe i shpalli: **“Kur të kalojnë muajt e shenjtë (në të cilët ndalohej lufta), atëherë i vritni idhujtarët kudo që t’i ndeshni, i zini robër, i rrethoni dhe u bëni pusi kudo. Por, nëse pendohen, falin namazin dhe japin zekatin, atëherë i**

43 Sure “Kaf”, ajeti 39.

44 Sure “Sexhde”, ajeti 24.

45 Sure “El A’raf”, ajeti 137.

lini të qetë! Vërtet, Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë”.⁴⁶

Kështu Allahu i shkatërroi ata me duart e të Dërguarit të Tij dhe të dashurve të tij, dhe ia dha atij shpërblimin e durimit, bashkë me atë që i është ruajtur për të në Botën Tjetër. Pra, kush duron dhe shpreson shpërblimin e Allahut, nuk largohet nga kjo botë, deri sa Allahu t’ia gëzojë sytë e tij me ndëshkimin e armiqve të tij, bashkë me atë që i ka përgatitur për të në Ahiret.

⁴⁶ Sure “Et Teube”, ajeti 5.

Turpi (*ndjeshmëria e brendshme*) i tij

Ebu Seid El Khuderi ka thënë: “I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte më i turpshëm se një virgjëreshë në dhomën e saj. Kur nuk e pëlqente diçka, ne e njihnim këtë në fytyrën e tij”.⁴⁷

Mbajtja e premtimit

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kishte lënë takim me një burrë te një shkëmb dhe i kishte thënë: ‘Unë do të të pres këtu, deri sa të vish’. Dielli nxehte shumë mbi të. Shokët e tij i thanë: ‘O i Dërguari i Allahut, sikur të shkoje nën hije’. Ai tha: ‘Unë i kam premtuar se do ta pres këtu, edhe, nëse nuk vjen. Kjo do të ishte një shkelje e premtimit’”.⁴⁸

Kur Imam Aliu e përshkruante të Dërguarin e Allahut, thoshte: “Ishte më bujari në dorë, më i guximshmi në

⁴⁷ “Mekarimul Akhlak”, f. 17; Kuptimi i parë është përcjellë në tefsirin “El Askeri”, f. 36.

⁴⁸ “Mekarimul Akhlak”, f. 24.

kraharor, më i singerti në fjalë, më besniku në marrëveshje, më i buti në natyrë dhe më fisniku në shoqëri. Kushdo që e shihte papritur, e ndjente frikërespektin ndaj tij, dhe kushdo që e njihte nga afër, e donte. Nuk kam parë të ngjashëm me të, as para tij dhe as pas tij”.⁴⁹

Trimëria e tij

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Kur përleshja bëhej e ashpër dhe ballafaqoheshin ushtritë, ne mbroheshim pas të Dërguarit të Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!). Askush nuk ishte më afër armikut se ai”.⁵⁰

⁴⁹ “Mekarimul Akhlak”, f. 18.

⁵⁰ “Mekarimul Akhlak”, f. 18.

FJALË TË SINGERTA

Brenda çdo njeriu dhe në thellësinë e ndërgjegjes së tij, gjendet një vend për sinqeritet, sado larg të shkojë, në Lindje apo në Perëndim. Ky sinqeritet i brendshëm do të shfaqet në formën e drejtësisë, e cila mbetet për historinë, që ta regjistrojë të vërtetën e pastër, ashtu siç është, larg sfidave të politikës, dredhive të epsheve dhe mashtrimeve të djajve të njerëzve dhe xhinëve.

Në rrjedhën e historisë kemi parë që shumë persona, nga Perëndimi apo Lindja, kanë mbajtur një qëndrim të sinqertë dhe nga zemra e tyre kanë shpërthyer fjalë që pasqyrojnë të vërtetën, ashtu siç është, të vërtetën e dritës muhamadane. Këtu do të sjellim disa shembuj të këtyre fjalëve.

FJALË TË SINGERTA NGA PERËNDIMI

Lamartine⁵¹: A ka ndonjë që është më i madh se Muhamedi?

Ai ka thënë: “Nëse kriteret, me të cilat masim gjenium e njeriut janë madhështia e qëllimit dhe rezultatet e mahnitshme që arrihen, pavarësisht mjeteve të pakta, atëherë, kush guxon ta krahasojë ndonjërin prej të mëdhenjve të historisë moderne me Profetin Muhamed, në gjenialitetin e tij?

Këta të famshëm kanë ndërtuar armë, kanë shpikur ligje dhe kanë ngritur perandori. Por nuk korrën tjetër veçse lavdi të kota, të cilat shpejt u shembën para syve të tyre. Ndërsa ky burrë, Muhamedi, nuk udhëhoqi vetëm ushtri, nuk shpalli vetëm ligje, nuk themeloi vetëm perandori, nuk sundoi vetëm popuj dhe nuk i përuli vetëm sundimtarët; por ai udhëhoqi miliona njerëz, në një kohë kur kjo përbënte një të tretën e botës së asaj kohe. Jo vetëm kaq, por ai, gjithashtu, zhdukuri idhujt, shigjetat fatthënëse, fetë, idetë dhe besimet e rreme.

⁵¹ Lamartine, mendimtar dhe poet francez. Fragment i shkëputur nga libri “Historia e Turqisë”, Paris, 1854, vëll. 2, f. 276-277.

Profeti duroi me qëndrueshmëri, derisa arriti fitoren (nga Allahu). Ambicia e Profetit Muhamed ishte tërësisht e drejtuar kah një qëllim i vetëm. Ai nuk synoi të themelonte një perandori apo diçka të ngjashme. Madje edhe namazi i tij i përhershëm, lutjet e tij ndaj Zotit, vdekja e tij dhe fitorja e tij edhe pas vdekjes, të gjitha këto nuk dëshmojnë për mashtrim e dredhi, por tregojnë bindjen e sinqertë, e cila i dha Profetit energjinë dhe forcën për të themeluar një doktrinë me dy shtylla: besimin në Njëshmërinë e Allahut dhe besimin në ndryshimin e Tij nga krijesat.

Shtylla e parë shpjegon cilësinë e Allahut (që është Njëshmëria), ndërsa tjetra sqaron se çfarë nuk i përket Atij (materia dhe ngjashmëria me krijesat). Për të realizuar të parën duhej shkatërruar me shpatë çdo hyjni e rreme përveç Allahut; ndërsa e dyta kërkonte përforcimin e besimit me fjalë (me urtësi dhe këshillë të mirë).

Ky është Muhamedi, filozofi, oratori, profeti, ligjvënësi, luftëtari, fituesi mbi pasionet, themeluesi i shkollave, që ftojnë në adhurim të vërtetë, pa idhuj e pa shigjeta fatthënëse. Ai është themeluesi i një perandorie shpirtërore të vetme. Ky është Muhamedi.

Duke parë, me të gjitha kriteret e madhështisë njerëzore, dëshiroj të pyes: A ka ndonjë që është më i madh se Profeti Muhamed? Ngjarja më e madhe në jetën time ishte se studiova me imtësi jetën e të Dërguarit të Allahut,

Muhamedit dhe kuptova çfarë madhështie e përjetësie ka në të. Cili burrë arriti në shkallë të tillë të madhështisë njerëzore siç arriti Muhamedi? Cili njeri arriti në shkallë të përsosmërisë siç arriti ai? Profeti Muhamed shkatërroi besimet e kota që vendosnin ndërmjetës mes Krijuesit dhe krijesës”.

Tomas Karlajl (Thomas Carlyle)⁵²: Ylli që ndriçoi mbarë botën

Ai ka thënë: “Është turp që ndonjë njeri nga ky brez të dëgjojë me veshë iluzionin e atyre që thonë se Islami është një gënjeshtër dhe Muhamedi nuk ishte në të drejtë. Ka ardhur koha t’i luftojmë këto pretendime qesharake e të turpshme, sepse mesazhi, të cilin e thirri ky Profet, ka mbetur një pishtar ndriçues për katërmbëdhjetë shekuj për miliona e miliona njerëz. A është vallë e arsyeshme që ky mesazh të jetë një trill i një gënjeshtari apo një mashtrim i një mashtruesi?

A keni parë ndonjë njeri gënjeshtar, që të krijojë një fe dhe ta përhapë atë në këtë mënyrë? Njeriu gënjeshtar nuk është i aftë të ndërtojë as një shtëpi prej tulle, ngaqë nuk njeh

52 Tomas Karlajl (Thomas Carlyle), “Muhamedi, shembulli më i lartë”.

vetitë e materialeve të ndërtimit. Edhe sikur ta ndërtojë, ajo që ngre, nuk është veçse një grumbull përzierjesh. E ç'të thuhet për atë që ndërtoi një "shtëpi" të mbështetur mbi themele për aq shumë shekuj dhe të banuar nga kaq shumë miliona njerëz?!

Prandaj është gabim i madh ta quajmë Muhamedin një njeri gënjeshtar, të shtirur apo që përdor dredhi e mjete për të arritur ndonjë interes apo qëllim personal. Mesazhi që ai përcolli, nuk ishte tjetër veçse e vërteta dhe drejtësia. Ai nuk ishte tjetër veçse një meteor (yll) që ndriçoi mbarë botën, dhe kjo është çështje e Zotit".

Pas kësaj, Karlajli kalon në rrëzimin e akuzave të tjera, duke e vërtetuar njëkohësisht madhështinë e moralit të Profetit Muhamed dhe lartësinë e sjelljes së tij. Ai thotë: "Fanatikët pretendojnë se Muhamedi, me thirrjen e tij, nuk kërkonte gjë tjetër veçse epshin personal, lavdinë dhe pushtetin... Jo, për Zotin! Nga zemra e këtij burri, me shpirt të madh, të mbushur me mëshirë, mirësi, bamirësi, dritë dhe urtësi, nuk dolën mendime që synonin përfitime tokësore, por qëllime të larta, përtej kërkimit të lavdisë dhe pushtetit.

Gënjeshtarët thonë se lakmia dhe dashuria për dynjanë ishin ato që e ngritën dhe e shtynë Muhamedin. Marrëzi, budallallëk dhe çmenduri është të shohësh me syrin e tyre! Ç'nevojë kishte një burrë i tillë, në tërë Arabinë, për kurorën e Cezarit apo për skeptrin e Khosrojt? Ai nuk

ishte si të tjerët, që pajtoheshin me gjendje të rreme dhe ndiqnin konsideratat e kota. Ai nuk pranoi kurrë të mbulohej me gënjeshtër dhe mashtrime. Ai qëndronte i veçuar me vetveten e tij madhështore dhe me të vërtetat e gjithësisë e të qenieve. Sekreti i ekzistencës shndriste para syve të tij, me madhësinë dhe bukurinë e tij, por edhe me frikën që mbartte”.

Gibon-Okli (Gibbon-Ockley)⁵³: Mbresë e paharrueshme

Gibon-Okli (Gibbon-Ockley) thotë: “Nuk është përhapja e thirrjes islame ajo që meriton admirim, por qëndrueshmëria dhe vazhdimësia e saj gjatë shekujve. Ende, edhe pas dymbëdhjetë shekujsh, mbresa e mrekullueshme që gdhendi Muhamedi në Mekë dhe Medinë ruan të njëjtën madhësi dhe forcë në shpirtin e indianëve, afrikanëve dhe turqve, që kohët e fundit u njohën me Kur’anin. Myslimanët arritën të qëndrojnë të bashkuar përballë sprovës së besimit në Zotin, ndonëse e njohën Atë vetëm përmes arsyes dhe ndjenjave njerëzore.

Thënia ‘Dëshmoj se s’ka Zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut’ është thjesht dëshmia e

53 Eduard Gibon dhe Simon Ockley, “Historia e Perandorisë së Lindjes”, Londër 1870, f. 54.

Islamit. Ndjenja e tyre për Hyjninë e Allahut (të Lartmadhëruar) nuk u ndikua aspak nga prania e sendeve të dukshme që merren si hyjni përveç Tij.

Nderi i Profetit dhe virtytet e tij nuk i tejkaluan kufijtë e virtyteve të njohura të njerëzimit. Gjithashtu, mënyra e tij e jetesës bëri që mirënjohja e sahabëve ndaj tij (për udhëzimin që u dha dhe për nxjerrjen e tyre nga errësira në dritë) të mbetej gjithnjë në kuadër të arsyes dhe fesë”.

Dr. Zvemer (Dr. Zwemer)⁵⁴: I fuqishëm dhe elokuent...

Zvemer i thotë: “Me siguri, Muhamedi ka qenë një nga udhëheqësit më të mëdhenj fetarë myslimanë. Për të është e drejtë të thuhet, gjithashtu, se ai ishte një reformator i aftë, një orator elokuent, një trim i guximshëm, një mendimtar i madh. Nuk është e lejuar t’i atribuojmë atij gjëra që bien ndesh me këto cilësi. Ja ky është Kur’ani që solli, dhe ja, kjo është historia e tij, që dëshmojnë për saktësinë e këtij pohimi”.

54 Dr. Zvemer (Dr. Zwemer), orientalist kanadez (1813–1900). Fragmenti është shkëputur nga libri i tij: “Lindja dhe zakonet e saj”.

Bernard Shou⁵⁵: Shpëtimtari i njerëzimit

Ai ka thënë: “Priftërinjtë në Mesjetë, si pasojë e injorancës ose fanatizmit, ia paraqitën fesë së Muhamedit një pamje të zymtë. Ata e konsideronin atë si armik të Krishterimit. Por unë e studiova çështjen e këtij burri dhe gjeta se ai është një mrekulli e jashtëzakonshme. Arrita në përfundimin se ai nuk ishte armik i Krishterimit, por duhet të quhet shpëtimtari i njerëzimit. Në mendimin tim, sikur ai të merrte sot drejtimin e botës, do të arrinte t’i zgjidhte problemet tona në mënyrë të tillë, që do të siguronte paqen dhe lumturinë, të cilat njerëzit i dëshirojnë”.

Ani Bezant (Annie Besant)⁵⁶: Një nga të dërguarit e mëdhenj të Zotit

Në librin e saj “Jeta dhe mësimet e Muhamedit” shkruan: “Është e pamundur për këdo që studion jetën dhe personalitetin e këtij Profeti të madh arab dhe mëson se si jetoi ai dhe si i mësoi njerëzit, të mos ndiejë respekt për këtë Profet të ndritur, një nga të dërguarit e mëdhenj të Zotit.

55 Bernard Shou, shkrimtar anglez (1817–1902). Ka shkruar një libër me titull “Muhamedi”, të cilin, autoritetet britanike, e dogjën.

56 Ani Bezant (Annie Besant), “Jeta dhe mësimet e Muhamedit”, Madras Publishing House, 1932.

Ndonëse unë do të përmend, në atë që do t'ju rrëfej, gjëra që mund të jenë të njohura për shumë njerëz, prapëseprapë unë ndiej një admirim dhe respekt të përtërirë për këtë mësues të madh arab. A doni të më thoni se një burrë, në kulmin e rinisë së tij, pa i kaluar të njëzet e katër vitet, pas martesës me një grua shumë më të madhe se ai në moshë dhe që i qëndroi besnik asaj për njëzet e gjashtë vjet, pastaj, kur arriti moshën pesëdhjetë vjeç, moshë kur pasionet trupore fillojnë të shuhen, u martua për të kënaqur dëshirat e tij? Jo! Nuk është ky gjykimi i drejtë për jetën e njerëzve. Po të shikoni gratë me të cilat u martua, do të shihni se çdo martesë nga ato kishte një qëllim: ose për të hyrë në një aleancë në dobi të ndjekësve të tij dhe fesë së tij, ose për të fituar diçka që sillte përfitim për shokët e tij, ose, sepse, gruaja me të cilën u martua, kishte nevojë të madhe për mbrojtje”.

***Leo Tolstoi (Leo Tolstoy)⁵⁷ thotë për Profetin Muhamed:
“Hapi rrugën e përparimit”***

Shkrimtari i madh botëror Leo Tolstoi, për të Dërguarin e Allahut, thotë: “Mjafton për nderin e

57 Leo Tolstoi (Leo Tolstoy) (1828–1910), shkrimtar i madh botëror, një nga figurat më të mëdha të letërsisë njerëzore, përshkruet i shpirtit të njeriut.

Muhamedit, që ai shpëtoi një popull të përulur e gjakatar nga kthetrat e zakoneve të këqija dhe u hapi atyre rrugën e përparimit dhe të zhvillimit. Ligji i Muhamedit do të mbizotërojë në botë, për shkak të përputhjes së tij me arsyen dhe urtësinë. Ligji i Kur'anit do të sundojë botën, sepse është në harmoni dhe përputhje me arsyen dhe mençurinë. Unë e kam kuptuar... kam arritur të kuptoj se ajo që i duhet njerëzimit, është një ligj hyjnor që ngre lart të vërtetën dhe shkatërron të pavërtetën. Unë jam një nga të mahniturit nga Profeti Muhamed, të cilin Zoti Një e zgjodhi që përmes tij të vinte shpallja e fundit, dhe që ai të ishte, gjithashtu, Profeti i fundit”.

Fransua Volter (François Voltaire)⁵⁸: Tërë lavdia i takon Muhamedit

Ai ka thënë: “Vërtet, në vetë shpirtin e Muhamedit ka diçka të mrekullueshme, të veçantë e të jashtëzakonshme, që e shtyn njeriun ta admirojë dhe ta vlerësojë. Pasha jetën time, ky burrë qëndroi i vetëm duke thirrur në emër të Zotit dhe duke duruar vuajtje për hir të kësaj thirrjeje për shumë

58 Fransua Volter (François Voltaire) (1694–1778), shkrimtar dhe filozof francez, një nga figurat më të mëdha të Iluminizmit, i njohur për kritikën e autoritetit fetar dhe politik. Në librin e tij “Muhamedi” ai ka thënë këto fjalë.

vite, ndërkohë që përballë kishte turma idhujtarësh që bënin çmos për ta kundërshtuar dhe për të vrarë idenë e tij. Ai, pra, e meriton gjithë respektin dhe lavdinë.

Për më tepër, në faza të ndryshme të jetës së tij, e shohim po atë njeri që nuk ia tërhiqte kurrë dorën një miku, që i donte fëmijët, të cilëve nuk kalonte pranë pa u sjellë me butësi, duke ndalur mes tyre me buzëqeshje e përulësi. Realiteti është se cilësitë me të cilat ishte pajisur Muhamedi, shuan çdo kritikë dhe nuk lënë vend veçse për admirim dhe respekt ndaj personalitetit të tij”.

Samuel Zwemer (Samuel Zwemer)⁵⁹: Shembujt më të mrekullueshëm

Ai ka thënë: “Gjenialiteti i Muhamedit ishte shkaku i suksesit dhe ngritjes së tij. Përveç kësaj, ai kishte njohuri të madhe mbi fetë e kohës së tij. Nuk ishte i aftë të linte pas dore të mirën, ofrimin e diturisë, shfaqjen e mirënjohjes dhe pranimin e të mirave që i bëheshin. Përkundrazi, ai dha për njerëzit shembujt më të mrekullueshëm dhe më prekës për zemrat. Një robëreshë e Ebu Lehebit, e quajtur Thuejbe, e

59 Samuel Zwemer (Samuel Zwemer) (1867–1952), protestant anglez, misionar dhe orientalist, redaktor i revistës angleze “The Muslim World”. Këto fjalë janë marrë nga libri i tij “Jezusi në lagjet e Gazaliut”.

kishte ushqyer me gji për disa ditë, para se ta merrte Halime Es Sadije për t'i gjdhënë. Kur Muhamedi e mësoi këtë, ia ruajti këtë të mirë dhe e njohu këtë nder. Sapo u bë i aftë për ta shpërblyer, u përpoq me të gjitha mundësitë. Madje, ai e nxiti bashkëshorten e tij, Hatixhen, që të bisedonte me Ebu Lehebin, për ta blerë këtë robëreshë, në mënyrë që ta lironte. Por Ebu Lehebi nuk pranoi. Megjithatë, mirësia e Muhamedit ndaj një gruaje si ajo vazhdoi për aq kohë sa ai qëndroi në Mekë”.

Xhon Davenport (John Davenport)⁶⁰ e quan Profetin Muhamed: “Njeriu i madh”

Për këtë personalitet po shkëputim këto fjalë, për figurën madhështore të Profetit Muhamed: “Sa më shumë që shohim tiparet e vërteta të Muhamedit, me syrin e mendjes dhe me kujdes, në burimet historike të sakta, aq më shumë e kuptojmë dobësinë e argumenteve dhe rrëzimin e provave që përdoren për të mbështetur sharjet e ashpra dhe fyerjet e shëmtuara, të cilat u hodhën mbi të nga gojët e dashakeqësve dhe të atyre që injoruan të vërtetën e Muhamedit dhe pozitën e tij. Ai është njeriu i madh te

60 John Davenport (1795–1863), orientalist anglez, këto fjalë i ka thënë në librin “Apologji për Muhamedin dhe Kur’anin”.

çdokush që ka studiuar cilësitë e tij madhështore. Si mund të mos jetë i tillë, kur ka sjellë një ligj, që nuk mund ta akuzojmë dot për të?”

Mahatma Gandhi⁶¹: Cilësitë e tij triumfuan

Ai ka thënë: “Dëshirova të njoh tiparet e burrit që zotëron, pa asnjë dyshim, zemrat e miliona njerëzve... U binda plotësisht se shpata nuk ishte mjeti përmes të cilit Islami fitoi pozitën e tij. Përkundrazi, ajo u arrit falë thjeshtësisë së Profetit Muhamed, përpikërisë së tij, sinqeritetit të tij në premtime, përkushtimit dhe besnikërisë ndaj miqve dhe pasuesve, guximit të tij dhe besimit të palëkundur te Zoti dhe misioni i tij. Pikërisht, këto cilësi hapën rrugën, kapërcyen vështirësitë dhe jo shpata. Pasi përfundova së lexuari pjesën e dytë të jetës së Profetit, më erdhi keq, që nuk kishte më shumë faqe për ta njohur edhe më shumë këtë jetë madhështore”.

61 Mahatma Gandhi, në një intervistë për gazetën “Young India”.

Ramakrishna Rao⁶²: Heroi i udhëve të jetës

Ai ka thënë: “Nuk është e mundur të njihet plotësisht personaliteti i Muhamedit, në të gjitha dimensionet e tij. Por ajo që mund të ofroj, është vetëm një pasqyrë e jetës së tij, nëpërmjet imazheve të bukura të njëpasnjëshme. Kemi Muhamedin profet, Muhamedin luftëtar, Muhamedin tregtar, Muhamedin politikan, Muhamedin orator, Muhamedin reformator, Muhamedin strehues të jetimëve, mbrojtës të skllëvërve, Muhamedin çlirues të grave, Muhamedin gjykatës. Të gjitha këto role madhështore, në çdo udhë të jetës njerëzore, e bëjnë atë të denjë për të qenë një hero”.

62 Prof. Ramakrishna Rao, në librin e tij “Muhamedi Profet”.

Fjalë të singerta nga Lindja

Xhorxh Xhordak (George Jordac): Zëri i Muhamedit

Nga përvëlimi i shkretëtirës së djegur, një flakë në sytë e tij!

Nga rrafshësia e rërave përballë zjarrmisë së diellit, një sinqeritet në buzët e tij!

Nga kopshtet e Jethribit (Medinës), shkurret e Taifit dhe oazet e Hixhazit që notojnë në hapësirë si ishuj të shpërndarë në një oqean rëre nën dritën e hënës, butësi në zemrën e tij dhe dhembshuri në gjakun e tij!

Nga stuhitë e egra të erës, një revoltë në imagjinatën e tij!

Nga elokuenca e poezisë dhe ndriçimi i qiellit, një magji në gjuhën e tij dhe një shkëndijë në shpirtin e tij!

Nga vendosmëria e sinqertë dhe gjuha e mendimit, një shkëlqim në shpatën e tij dhe një mesazh në dorën e tij të djathtë!

Ky është Muhamedi, i biri i Abdullahut, Profeti i arabëve dhe shkatërruesi i paganizmit, që e largoi njeriun nga vëllai i tij njeri – paganizmi i parasë, paganizmi i zakonit dhe raca e marrë!

Fiset Kurejsh e përmblihdnin botën në një dirhem që rrëshqiste nga dora e bedunit për të përfunduar në xhepat e tyre. Ata e matnin vlerën e jetës me një tregti fitimprurëse, me përfitim pas përfitimi, me karvanë që lëviznin nëpër luginat dhe grykat, duke përshkuar shkretëtirën sipas melodisë së dëshirës, pa gjetur strehë tjetër përveç hijes së ndonjë peme kurejshe, dhe pa gjetur tjetër stacion veçse në Mekën pagane, ku dirhemi është krenar dhe dinari mburret.

Në veshët e tyre ushtoi një zë që i drodhi nervat e tyre, ua copëtoi dëshirat dhe ua tronditi botën, duke thënë: “Njeriu ka një vlerë tjetër nga ajo që njihni ju! Edhe beduini që endet në shkretëtira ka një mision tjetër nga ai që i përshkruani ju!”

Ai zë, ishte zëri i Muhamedit!

Fiset Esed dhe Temim vijuan rrugën e marrëzisë, e nxituan ecjen drejt humnerave të devijimit dhe vazhduan të varrosnin vajzat e tyre për së gjalli – pa pasur ndonjë arsye tjetër përveç ndjekjes së zakonit, forcimit të asaj që e kishte shtrembëruar njeriu nga shenjat e Krijuesit, mohimit të bukurisë së natyrës dhe shëmtimit të mahnisë së universit.

Në veshët e tyre u përhap një zë i butë – që e mbartnin filladet e dhembshurisë, rrahjet e dashurisë dhe pëshpëritjet e jetës, duke thënë: “Largohuni nga varrosja për së gjalli, o robër të Zotit! Femra nga mesi juaj ka të njëjtën të drejtë si mashkulli! Asnjë krijesë nuk ka të drejtën të vendosë mbi jetën apo vdekjen e një tjetri, vetëm Zoti është Ai që jep jetë dhe e merr atë!”

Ai zë – ishte zëri i Muhamedit!

Beduinët u përfshinë në sakrificë me tehun e shpatës, u përplasën me gjuhë që përngjanin me kamxhikët e ferrit, puthnin buzët e virgjërshave në majat e shpateve... Derisa u bënë një përzierje kalorësish krenarë, burra që rrëzonin të tjerët, fëmijë që qanin e kërkonin ndihmë – duke u rritur pa dashuri dhe pa vëllazëri...

Dhe ushtoi në çadrat e tyre një zë më i fuqishëm se bubullima, më i tmerrshëm se stuhia, që përsëriste dhe thoshte: “Çfarë është kjo që po bëni? A është e lejueshme për ju të luftoni, ndërkohë që jeni vëllezër në Krijuesin e qiellit dhe të tokës? Lufta është nga veprat e djallit, paqja është më e denjë për ju, dhe në të ka shije të kënaqësisë që ju dëshironi!”

Ai zë – ishte zëri i Muhamedit!

Arabët përjetuan krenarinë, siç nuk e ka përjetuar asnjë popull e asnjë komb tjetër. Shfaqën përçmim ndaj

joarabëve, ashtu siç e shfaq vetë mendjemadhësia, arroganca dhe sjellja e çuditshme e të dehurit. Të huajt pësuan nga poshtërimi aq shumë, sa u cenua dinjiteti i tyre njerëzor.

Kjo e lëndoi thellë bartësin e mesazhit – dhe arrogantët u zgjuan nga një zë që thoshte: *“Nuk ka asnjë epërsi arabi ndaj një joarabi, përveçse në devotshmëri. Njeriu është vëllai i njeriut, qoftë i dashur apo i padëshiruar!”*

Ai zë – ishte zëri i Muhamedit!

Po ata të munduarit në tokë? Po ata të dëbuarit që i dogjën erërat djegëse të shkretëtirës, që u përzunë nga shoqëria që punëson dhe flak, të cilëve jeta ua ngushtoi horizontin, deri sa u bënë më të pavlerë se grimcat e rërës dhe jeta e tyre shkruhej në faqe të zeza...

Ata ishin miqtë e bartësit të mesazhit, ashtu siç ishin të varfrit dhe të përbuzurit miq të Krishtit, Jezusit, birit të Marisë dhe miq të të gjithë të mëdhenjve të tokës.

Për hir të tyre, ai e vendosi këshillimin e përbashkët si bazë të qeverisjes, ndaloi skllavërinë dhe shfrytëzimin e njeriut nga njeriu, e shpalli të përbashkët Thesarin Publik (*Bejtul Malin*) dhe përpjekjet e njerëzve, dhe rrahu me kamxhik kushërinjtë e tij kurejsh, në mënyrë të drejtë dhe pa favorizime.

Me gjithë qenien e tij, ai synonte unitetin e gjithësisë, të mishëruar në një Zot të vetëm, ndërkohë që njerëzit e marrë dhe fëmijët nxiteshin kundër tij, e qëllonin me gurë dhe talleshin me të.

Por ata, të munduarit në tokë, të dëbuarit dhe skllëvërit, ndër ta edhe Bilali, thirrësi i parë i ezanit në Islam dhe muezini i Profetit, zemrat e tyre u hapën ndaj atij zëri që kishte jehonë më të thellë se himni i mëngjesit, më autoritet se heshtja e natës, dhe më ndikues në shpirt se vetë zëri i fatit, që thotë: *“Të gjithë krijesat janë familja e Zotit, dhe më i dashuri për Të është ai që është më i dobishëm për familjen e Tij.”*

Ai zë – ishte zëri i Muhamedit!

Sa për kundërshtarët e tij, ata që e qëlluan me gurë dhe ata që u tallën me të, nga goja e tij dëgjuan këtë zë që jep jetë: ***“E sikur të ishe i ashpër dhe zemërgur, do të ishin shpërndarë prej teje. Prandaj, fali ata, kërko falje për ta dhe këshillohu me ta në çështje. E kur të vendosësh, atëherë mbështetu tek Zoti – vërtet Zoti i do ata që mbështeten tek Ai”.***

Ai zë – ishte zëri i Muhamedit!

Sa për luftëtarët për një jetë më të mirë, për mbështetësit e tij kundër së keqes, dhe për ata që mund t'i shtynte vetja për të shkelur të drejtat dhe dinjitetin e

njerëzve në çaste lufte dhe mbrojtjeje të një revolucioni të drejtë – në zemrat e tyre janë ngulitur këto fjalë madhështore: *“Mos tradhтони, mos mashtroni, mos vrisni fëmijë, as gra, as plak të shtyrë në moshë, as eremitin që është mbyllur në faltoren e tij. Mos digjni palmën, mos prisni pemë, e mos shkatërroni ndërtesa”*.

Ai zë – ishte zëri i Muhamedit!

Arabët, nga biri i Abdullahut, trashëguan atë zë fisnik dhe me të u përhapën në fillim mbi sipërfaqen e tokës, deri sa me të mposhtën çdo mbret e çdo sundimtar. Forcuan lidhjen mes njeriut dhe njeriut dhe mes njeriut dhe shpirtit të krijesave, të cilat Profeti i shkretëtirës i mishëroi në një Zot të drejtë, të vetëm dhe pa ortak. Hija e Muhamedit, birit të Abdullahut, u zgjerua dhe u rrit, deri sa mbuloi të gjithë botën e vjetër.

Dhe ja, nga lindja e diellit e deri në perëndimin e tij, toka filloi të japë mirësi, dije dhe paqe. Profeti i shkretëtirës shtriu dorën e tij mbi tokë, për të mbjellë në të farat e vëllazërisë dhe të dashërisë. Shteti i arabëve kishte tashmë një dorë në Indi dhe një tjetër në Andaluzi. Dhe në ballin e diellit u vendos kurora e një populli madhështor.

Mbi atë zë u ngrit thirrja për vëllazëri njerëzore dhe për largimin e duarve të sundimtarëve nga populli, pasuria dhe përpjekjet e tij, dhe për barazinë e njerëzve në të drejta:

të vegjlit e të mëdhenjtë, të sunduarit e sunduesit, arabët dhe joarabët, sepse njerëzit janë të gjithë vëllezër të barabartë!.

Mbi atë zë u ngrit thirrja për çlirimin e gruas nga padrejtësia e burrit, çlirimin e punëtorit nga padrejtësia e punëdhënësit dhe çlirimin e skllevërve dhe shërbëtorëve nga robëria dhe poshtërimi, sipas mendimit të kohës dhe natyrës së shoqërisë, si dhe për pjesëmarrjen e popullit në qeverisje, ndryshe nga filozofët e lashtësisë që kishin vendosur privimin e punëtorëve, zejtarëve dhe skllevërve nga të drejtat civile, për shkak të “ulësisë” së profesioneve dhe zejeve që ata ushtronin, duke e ndarë botën në klasa me të drejta dhe detyrime të ndryshme!

Ishte më e mira që mund të arrihej për të mirën e përbashkët, sipas logjikës dhe mundësive të asaj kohe.

U ndalua kamata dhe shfrytëzimi i njeriut nga njeriu.

Ishte një revolucion kundër një shoqërie që ushqej nga çdo padrejtësi dhe dhunë!”⁶³

63 Nga libri “Zëri i drejtësisë njerëzore”.

Pol Salame (Paul Salameh): Madhështia e një njeriu

Një i krishterë që përkulet para madhësisë së një njeriu, emrin e të cilit e thërrasin qindra miliona njerëz, në lindje e në perëndim të tokës, pesë herë në ditë.

Një njeri që në mesin e të gjithë bijve të Evës – nuk ka asnjë më madhështor në qëllim, më ndikues në histori dhe më të pavdekshëm në përmendje. Një njeri që doli nga errësira e injorancës paraislame dhe bashkë me të erdhi një botë e re, mbi të cilën u ngrit një flamur madhështor, ku ishte shkruar me shkronja drite: “Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut! Allahu është më i madhi!”⁶⁴

⁶⁴ Nga poema epike “El Gadir”.

Përfundimi

Po të mos ishte Profeti Muhamed, agimi i vërtetë i njerëzimit, nuk do të përpiqeshin të gjitha kurthet e errësirës ta rrethonin me gjithë fuqinë ushtarake, mediatike, kulturore e shpirtërore...

Po të mos ishte Profeti Muhamed, shpresa e njerëzimit, nuk do të kishte zënë vend në zemrat e miliona të shtypurve përgjatë shekujve.

Po të mos ishte Profeti Muhamed, ndjenja e pastër njerëzore, nuk do të ishin përrulur ndaj emrit të tij të gjitha zemrat e singerta, lindore apo perëndimore.

Po të mos ishte Profeti Muhamed, i dërguari i mëshirës, nuk do të kishin dalë kundër tij të gjithë faraonët e kohëve.

Muhamedi – është një emër që do të mbetet në qendër të qenies njerëzore, rreth të cilit do të sillen epokat dhe kohët – dritë për ata që ecin, zjarr për arrogantët.

Një sfidë që e dimë se nuk do të përfundojë, deri sa të shfaqet i premtuari nga pasardhësit e Muhamedit, i cili do ta mbushë botën me drejtësi dhe barazi.

Falënderimi i qoftë Allahut, Zotit të botëve!

Përmbajtja

Hyrje.....	5
PROFETI I PASHKOLLUAR, MËSOI DHE EDUKOI POPUJ	7
Ndërtimi i xhamisë	14
Vëllazërimi	15
Drita e të Dërguarit të Allahut	23
Takimet e tij.....	24
Ulja e tij	25
E folura e tij	29
Me njerëzit.....	30
Me të varfrit	32
Përmbushja e nevojave.....	33
Kujdesi për pamjen e jashtme	33
Përlësia e tij	35
Durimi i tij.....	38
Turpi (<i>ndjeshmëria e brendshme</i>) i tij.....	42
Mbajtja e premtimit.....	42

Trimëria e tij.....	43
FJALË TË SINGERTA	44
FJALË TË SINGERTA NGA PERËNDIMI	45
Lamartine: A ka ndonjë që është më i madh se Muhamedi?	45
Tomas Karlajl (Thomas Carlyle): Ylli që ndriçoi mbarë botën.....	47
Gibon-Okli (Gibbon-Ockley): Mbresë e paharrueshme. 49	
Dr. Zvemer (Dr. Zwemer): I fuqishëm dhe elokuent....	50
Bernard Shou: Shpëtimtari i njerëzimit.....	51
Ani Bezant (Annie Besant): Një nga të dërguarit e mëdhenj të Zotit.....	51
Leo Tolstoi (Leo Tolstoy) thotë për Profetin Muhamed: “Hapi rrugën e përparimit”	52
Fransua Volter (François Voltaire): Tërë lavdia i takon Muhamedit	53
Samuel Zvemer (Samuel Zwemer): Shembujt më të mrekullueshëm	54
Xhon Davenpërt (John Davenport) e quan Profetin Muhamed: “Njeriu i madh”	55
Mahatma Gandi: Cilësitë e tij triumfuan	56
Ramakrishna Rao: Heroi i udhëve të jetës.....	57
Fjalë të singerta nga Lindja.....	58

Xhorxh Xhordak (George Jordac): Zëri i Muhamedit	58
Pol Salame (Paul Salameh): Madhështia e një njeriu	65
Përfundimi	66
Përmbajtja.....	67

إسم الكتاب: هذا رسول الله

إعداد ونشر: جمعية المعارف الإسلامية الثقافية

الترجمة: الشيخ ولنت (عباس) مريا

التصحيح الأدبي: يريدا كولا

التصحيح اللغوي: إسرا مريا

الإخراج النهائي: صرييه فزا

الغالف: صرييه فزا

الناشر: جمعية النسيم

تيرانا، 2025